



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilajeno Me/Dana

17-09-2019

Nr. i organit  
Org. broj

Numri/Broj

Shtojcë  
Prilog

Vlera  
Vrednosë

02-052/01-963

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim

&

Zyra për Informim Publik dhe marrëdhënie me publikun

## RAPORT NARRATIV PËR DISKUTIMET PUBLIKE PËR PLANIFIKIMIN E BUXHETIT KOMUNAL 2020-2022 TË MBAJTUR NË GUSHT TË VITIT 2019

### Aktiviteti: Diskutimi Publik i Buxhetit për vitin 2020-2022

Në bazë të Ligjit për Financa publike dhe përgjegjësi, Komuna e Vitisë-Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim në bashkëpunim me Zyrën për Informim dhe marrëdhënie me Publikun, me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për periudhën 2020-2022, gjatë muajit gusht të vitit 2019, ka mbajtur diskutimet publike me qytetarë rreth planifikimit të buxhetit komunal 2020-22, me theks të veçantë projeksionin buxhetor për vitin 2020.

Diskutimet publike për buxhetin 2020-2022, janë mbajtur sipas këtij orari:

Data e diskutimit publik	Lokaliteti / Vendbanimi	Numri i pjesëmarrësve			Komentet
		M	F	Total	
15.08.2019	Viti	15	19	34	<b>Përfundimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>➤ Rregullimi i kanalizimit prapa objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit.</li><li>➤ Rregullimi i Komunikacionit në udhëkryqin Viti-Pozheran konkretisht implementimin e Planit të Mobilitetit me qëllim të uljes së rrezikut nga aksidentet në komunikacion.</li><li>➤ Mbylljen e bulevardit të qytetit për mjetet motorike.</li><li>➤ Rregullimin e kulmit të shkollës "Dëshmorët e Vitisë" në Viti.</li><li>➤ Rregullimin e kanalizimit në rrugën</li></ul>

					<p>“Sherif Frangu”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rritja e kapaciteteve të ujit brenda qytetit.</li> <li>➤ Vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale dhe të shenjave të komunikacionit.</li> <li>➤ Emërimin e një rruge brenda qytetit me emrin e dëshmorit Rashit Mustafa-Komandant Karadaku.</li> <li>➤ Sigurimi i një strehimore për qenët endacak.</li> <li>➤ Digjitalizimit që është bërë i shkollave me laptop të bëhet edhe pajisja e tyre me projektor.</li> </ul>
16.08.2019	Vërban	46	2	48	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rregullimi i njeve sanitare në shkollë.</li> <li>➤ Rregullimi i një pjese të rrethojës në oborrin shkollor.</li> <li>➤ Funkcionalizimi i ujësjellësit.</li> <li>➤ Mirëmbajtja e kanalizimit.</li> <li>➤ Vazhdimi i trotuarit.</li> <li>➤ Pastrimi i përroskave.</li> <li>➤ Rregullimi i rrugës prej Sokolve deri të Fabrika e Batarive.</li> <li>➤ Rregullimi i rrugëve bujqësore.</li> <li>➤ Pastrimi i rrugëve lagjore nga bora gjatë stinës së dimrit.</li> <li>➤ Ndrichi publik nëpër lagje.</li> <li>➤ Krijimi i vendeve të punës dhe mirëmbajtja e oborrit shkollor.</li> </ul>
16.08.2019	Smirë	12	0	12	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të rritet buxheti në sektorin e shëndetësisë.</li> </ul>

					<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të vazhdohet me ndriçimin publik.</li> <li>➤ Të realizohen kërkesat që janë paraqitur edhe më parë nga banorët e fshatit Smirë, Të vazhdohet me ndërtimin e trotuarit.</li> <li>➤ Të rregullohen disa rrugë fushore. Rregullimi i defekteve në rrjetin e kanalizimit.</li> <li>➤ Të zgjidhet problemi me qenët endacak.</li> <li>➤ Të rregullohen gropat septike.</li> <li>➤ Të ndërtohet një sallë e sportit për shkollën dhe të vendosën panelat solare në kulmin e shkollës.</li> <li>➤ Të rritën investimet e komunës në këtë fshat.</li> <li>➤ Të pastrohet nga barojat rruga Goshicë-Smirë.</li> <li>➤ Të bëhet dezinfektimi i rregullt i objektit shkollor.</li> </ul>
19.08.2019	Gjylekar (Skifteraj)	15	4	19	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Sigurimi i ujit të pijëshëm.</li> <li>➤ Rregullimi i rrugëve bujqësore.</li> <li>➤ Kompletimin i projektit të ndriçimit publik.</li> <li>➤ Rregullimi i rrethojës së shkollës dhe i nyjeve sanitare në shkollë</li> </ul>
19.08.2019	Ballancë	8	0	8	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rregullimi i rrjetit të kanalizimit.</li> <li>➤ Vendosja e rrethojës dhe fushës sportive në oborrin e shkollës për nxënës dhe rininë e fshatit.</li> <li>➤ Vendosja e ndriçimit publik të rrugëve të fshatit.</li> </ul>

					<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Riparimi i rrjetit elektrik dhe ndërrimi i shtyllave elektrike.</li> </ul> <p>Sqarim: Prioritet e tjera i dorëzuan edhe me shkrim.</p>
20.08.2019	Sadovinë e Jerlive	27	0	27	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rregullimi i kanalizimit në të gjithë fshatin, konkretisht në lagjet e mbetura.</li> <li>➤ Të bëhet funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit ose kyçja në rrjetin e ujësjellësit të Letnicës.</li> <li>➤ Të bëhet rregullimi i rrugëve bujqësore në: drejtim të arave të Begracës, në drejtim të fshatit Goshicë dhe për skaj të kanalit.</li> <li>➤ Të bëhet edhe asfaltimi i rrugëve: tek stadiumi "Gursel e Bajram Sylejmani", Rruga "Bekim Miftari" Rr. "Bardhyl Fetahu" dhe disa rrugë të tjera.</li> <li>➤ Të bëhet mirëmbajtja e Stadiumit me objektet përcjellëse, të bëhet vendosja e rrethojave në oborrin e shkollës.</li> <li>➤ Të bëhet kompletimi i ndriçimit publik në lagje.</li> <li>➤ Të bëhet rregullimi i fushës së vogël të futbollit.</li> <li>➤ Të bëhet ndërtimi i trotuarit deri në fshatin Remniku i Ri.</li> <li>➤ Të bëhet rregullimi i parkingjeve .</li> </ul>
20.08.2019	Sllatinë e Epërme	28	4	32	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të bëhet funksionalizimi i ambulantes.</li> <li>➤ Të funksionalizimet rrjeti i ujësjellësit.</li> <li>➤ Të rritën hapësirat gjelbëruese në</li> </ul>

					<p>fshat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të vendosën më shumë ujëmbledhës për skaj të rrugëve.</li> <li>➤ Të rregullohet hapësira në parkun "Mllaku".</li> <li>➤ Të bëhet zgjerimi i urës së fshatit.</li> <li>➤ Të bëhet asfaltimi i të gjitha rrugëve lagjore.</li> <li>➤ Të kyçen në rrjetin e kanalizimit lagjet e mbetura.</li> <li>➤ Të ndërtohen trotuare në lagje.</li> <li>➤ Të rregullohet fusha sportive tek shkolla.</li> <li>➤ Të bëhet një Memorandum bashkëpunimi në mes të Komunës së Vitisë dhe Komunës së Ferizajt që të ndërtohet trotuari që lidhë Komunën e Vitisë me Ferizajin ku shumë nxënës të fshatit Sllatinë ndjekin mësimet.</li> <li>➤ Të bëhet ndërtimi i një objekti të ri të Ambulantës së fshatit.</li> <li>➤ Të rregullohen rrugët e "Zuqit", "Kopecëve", "Lisat", "Hamit Llulleci" me segmente.</li> <li>➤ Të rregullohet një park pranë shkollës fillore "Nijazi Rexhepi", konkretisht në rrugën "Hamit Llulleci".</li> </ul>
21.08.2019	Pozheran	20	4	24	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të ndërtohet një fushë ndihmëse në Pozheran.</li> <li>➤ Të përfundojnë sa më parë punimet në stadiumin "Ibrahim Kurteshi".</li> <li>➤ Lagjet "Zuka", "Alidema" dhe "Pira" të bëhen me trotuar.</li> </ul>

					<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të zgjidhën problemet me ujërat e zeza.</li> <li>➤ Të ndërtohet një objekt për aktivitetet kulturore.</li> <li>➤ QMF në Pozheran të pajisët me Automabulancë.</li> <li>➤ Të punohet në rrugët bujqësore.</li> <li>➤ Të bëhet hapja e kanaleve për skaj të rrugëve bujqësore.</li> <li>➤ Të vazhdohet me pastrimin e përroskave.</li> <li>➤ Të ndërtohen më shumë gropa septike.</li> <li>➤ Të hapët rruga e vjetër prej Xhamisë deri të Rruga e Zajmit.</li> <li>➤ Komuna e Vitisë në investimet kapitale të merre parasysh kërkesat që kanë dalë nga ky takim.</li> </ul>
22.08.2019	Sportistët	9	2	11	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të rritet buxheti për sportin.</li> <li>➤ Të investohet më shumë në infrastrukturën e sportit.</li> <li>➤ Të rregullohet poligoni i qitjes.</li> <li>➤ Të bëhet subvencionimi i klubeve dhe i sportistëve sipas të arriturave të tyre.</li> <li>➤ Të ju jepet gjatë subvencionimit prioritet klubeve e sportisteve të cilët marrin pjesë në garat e ndryshme dhe që përfaqësojnë vendin.</li> </ul>
21.08.2019	Tërpezë	18	0	18	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të ndërtohen trotuare.</li> <li>➤ Të pajisjen të gjitha rrugët me ndriçim publik.</li> </ul>

					<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të bëhet vazhdimi i rrugës për të varrezat dhe zgjerimi i rrugës aktuale.</li> <li>➤ Të rregullohet rruga bujqësore që lidhë Tërpezën me Fshatin e Ri.</li> <li>➤ Të vendosët një murë mbrojtës në humnerën pranë rrugës Balaj.</li> <li>➤ Të rregullohet çështja e ujit të pijes.</li> <li>➤ Të ndërtohet një ambulancë e fshatit.</li> </ul>
23.08.2019	Fermerët	12	3	15	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të rritet buxheti për bujqësi.</li> <li>➤ Të subvencionohen fermerët me farëra, fidane, plehra artificial, mekanizëm bujqësor.</li> <li>➤ Të bëhen marrëveshje që çmim i derivateve të naftës të jetë më i lirë për fermerët.</li> <li>➤ Shqetësim: Importimi i mallrave nga vendet e rajonit të cilët sipas tyre po e dëmtojnë sektorin e bujqësisë.</li> </ul>
27.08.2019	Gjinia femërore	0	55	55	<p><b>Përfundimet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të hapët edhe një çerdhe publike në komunën e Vitisë</li> <li>➤ Të këtë më shumë trajnime për gratë të cilët janë të interesuar të hapin biznese të reja.</li> <li>➤ Të organizohen trajnime vetëdijësuese për të rinjtë në parandalimin e konsumit të narkotikëve.</li> <li>➤ Të rritet fondi i librave në bibliotekën për fëmijë dhe bibliotekat e shkollave.</li> <li>➤ Të këtë më shumë psikolog në shkolla</li> <li>➤ Të hapët një zyre këshillimore për nxënësit në të cilën do të jenë të</li> </ul>

						angazhuar psikologë.  Të subvencionohen shoqatat të cilat merren me të drejtën e barazisë gjinore në veçanti të grave.
23.08.2019	Komuniteti jo shumicë (kryesisht serb)	7	3	10		<b>Përfundimet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mësimdhënësit e shkollës "Mladën Markoviç të hynë në sistemin e pagës së Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës.</li> <li>➤ Të bëhet rregullimi i gypit të ujësjellësit në fshatin Binçë si dhe shkolla e fshatit Binçë. Dhe të kyçet në rrjetin e ujësjellësit të këtij fshati.</li> </ul>
<b>Totali i pjesëmarrësve</b>		<b>217</b>	<b>96</b>	<b>313</b>		
<b>Përqindja:</b>		<b>69.3</b> <b>3%</b>	<b>36.6</b> <b>7%</b>	<b>100%</b>		

#### Publikimi në media:

Diskutimet për buxhet janë përcjellë nga Zyra për Informim Publik e Komunës së Vitisë dhe gjitha këto aktivitete janë publikuar në faqen zyrtare të internetit : [www.kk.rks-gov.net/viti](http://www.kk.rks-gov.net/viti) dhe në facebook Komuna e Vitisë.

Gjithashtu këto informacione janë prezantuar edhe në portalet:

1. Rajonipress: rajonipress.com
2. Plus Tv: plus-televizion.tv
3. 2Lonline: 2Lonline.com
4. RTV Iliria: rtviliria.com
5. Gazeta Koha Ditore
6. Kryelajmi.com
7. Gjilani.info
8. Artlajm.info
9. Si dhe disa medime të tjera...

Viti: ~~13.09.2019~~

11.05.2019


